



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE FISKALE  
DHE E TË ARDHURAVE PUBLIKE  
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE E MARRËDHËNIEVE FISKALE

Nr. 6837 / Prot .  
1

Tiranë, më 6./05/2014

**Drejtuar:** QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

*Adresa: Bulevardi Zhan D' Ark, Tiranë.*

**Për dijeni:** ZNJ. BRISIDA SHEHAJ

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve  
*Adresa: Rr. "Gjin Bue Shpata", Tiranë*


**Subjekti:** Dërgohet për publikim

Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 13, datë 6.5.14, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 32 datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël".

Të merren masat për publikimin e menjëhershëm të tij në Fletoren Zyrtare.

SHKËLQIM CANI

*Konceptoi:* Zarina Taja, (Specialist)  
*Konfirmoi:* Arjana Dyrmishi, (Drejtor)  
*Miratoi:* Gelardina Prodani (Sekretar i Përgjithshme)  
*Data:* 05.05.2014





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE

Nr. 6834

dt. 6.5.14

UDHËZIM

Nr. 13, datë 6.5.2014

**«PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 32, DATË 31.12.2013 «PËR  
TATIMIN  
E THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL»»**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Në pikën 10 “Administrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, në fund të paragrafit të parë, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:  
“Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim” me kartela analitike për çdo Bashki dhe Komunë.”
2. Në pikën 11 “Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore”, në gjurmën c) shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në aktrakordimin e hartuar në tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuara për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara.

Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të aktrakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale “Tatime me deklarim”, në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës.

Drejtoria rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të aktrakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të aktrakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 "Transferata në institucionet nacional" në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në Drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 "Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale".

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

**SHKËLQIM CANI**

  
**MINISTËR**



### AKT - RAKORDIMI

I mbatur me date \_\_\_\_\_, midis Drejtorise Rajonale Tatimore \_\_\_\_\_ dhe Komunes/  
Bashkise \_\_\_\_\_,

lidhur me Totalin e shumes se arketuar, nga Tatimi I Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit te Vogel, ne llogarine perkatese te DRT-se,  
per periudhen nga data \_\_\_\_\_ deri me date \_\_\_\_\_.

Lloji I Takses	Emri I Komunes/Bashkise	Llogaria kontabile (ku kane kaluar arketimet)	Muaji ne te cilin jane bere arketimet	Shuma e arketuar gjithsej (ne leke)	Shuma e te ardhurave per Komunen/Bashki ne (99% e totalit)	Shuma e te ardhurave qe I takon DRT-se (1% e totalit)
1	2	3	4	5	6=5 x 99%	7 = 5 x 1%
Tatimi I Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit te Vogel		4481100	01 deri 00/00/2014			

**Shenim:** Akt-Rakordimi perpilohet ne tre kopje. Akt-Rakordimit I bashkangjitet Lista e Tatimpaguesve te konfirmuar nga te dyja palet. Shuma totale e a tatimit te arketuar (shuma ne kollonen 5) duhet te jete e barabarte me shumen Totale te listes (sipas Udhezimit Nr32, dt. 31/12/2013) bashkangjitur akt-rakordimit.

Per Komunen/ Bashkine \_\_\_\_\_

Per Drejtorine Rajonale Tatimore \_\_\_\_\_

Nenpunesi Zbatues (Emer Mbiemer)

Nenpunesi Zbatues (Emer Mbiemer)

Nenpunesi Autorizues (Emer Mbiemer)

Nenpunesi Autorizues (Emer Mbiemer)